



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.39

2004

17 Qershor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MF - MD
nr.3165, datë 12.5.2004

Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët 2833

Vendim i GJK
nr.11, datë 27.5.2004

Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 6 pika 9 dhe nenit 11 pika 3 shkronja "b" të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", si dhe nenit 31 pikat 1 e 3 dhe nenit 16 pika 1 shkronja "c" të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" 2835

UDHËZIM
Nr.3165, datë 12.5.2004

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË PËRKTHYESVE TË JASHTËM, TARIFAT E SHPËRBLIMIT TË PËRKTHYESVE TË JASHTËM DHE TARIFAT E PËRKTHIMIT ZYRTAR QË DUHET TË PAGUAJNË TË TRETËT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutes dhe të nenit 12 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë (i ndryshuar), Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Ministri i Drejtësisë miraton listën vjetore të përkthyesve të jashtëm të Ministrisë së Drejtësisë për vitin pasues kalendarik me tre përkthyes për çdo gjuhë komunikimi të përcaktuar në konventat ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti.

2. Lista vjetore e përkthyesve të jashtëm të Ministrisë së Drejtësisë dhe gjuhët respektive i paraqiten Ministrin të Drejtësisë nga Drejtoria e Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar brenda datës 10 dhjetor në bazë të renditjes së kandidatëve të paraqitur pas konkurrimit sipas procedurave të mëposhtme.

Kur numri i kandidatëve të paraqitur për një gjuhë është jo më i madh se tre, konkurrimi do të zhvillohet në një datë tjetër, të mëvonshme.

3. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të Shërbimeve bën njoftimin në lidhje me kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për përkthyes të jashtëm sipas pikës 9 të këtij udhëzimi, si dhe afatet e pranimit të dokumenteve, pranë Ministrisë së Drejtësisë, brenda datës 1 nëntor, jo më pak se dy herë, në dy nga gazetatat me qarkullim në të gjithë vendin dhe në dy nga kanalet televizive kombëtare.

DBGJN-ja administron kërkesat e ardhura, përgatit dosjen përkatëse me të dhënat profesionale të kandidatëve dhe bën njoftimin për datën dhe mënyrën e testimit.

4. Përbërja dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit të testimit të kandidatëve për përkthyes, miratohen nga Ministri i Drejtësisë brenda datës 15 nëntor.

5. KTKPJ-ja për çdo gjuhë ka në përbërje të tij një pedagog për çdo gjuhë testimi, mësimdhënia apo mbrojtja e së cilës ofrohet në Universitetin e Tiranës, si dhe dy përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

6. Në përfundim të testimit, KTKPJ-ja për çdo gjuhë testimi dorëzon vlerësimin përfundimtar të firmosur nga jo më pak se 2/3 e anëtarëve, duke i renditur kandidatët sipas gjuhës dhe totalit të pikëve të marra në të dyja fazat e konkurrimit. Maksimumi i pikëve është 100 pikë; 30 pikë nga të dhënat profesionale pas vlerësimit të CV-së, nga komisioni dhe 70 pikë nga njohuritë gjuhësore dhe aftësitë kompjuterike pas testimit me shkrim.

7. Sekretari i Përgjithshëm, brenda datës 20 dhjetor, lidh kontratat individuale (tip) me çdo përkthyes. Në rast se përkthyesi i miratuar në listën vjetore të përkthyesve të jashtëm tërhiqet nga lidhja e kësaj kontrate apo njëra nga palët e prish atë më pas, Sekretari i Përgjithshëm kontraktin kandidatin e renditur menjëherë pas tij. Kontratat në fjalë përfundojnë pas lidhjes së kontratave të reja për vitin pasues.

8. Në rast se gjatë vitit del nevoja për përkthim në dhe nga gjuhë të papërfshira në listën vjetore, me propozim të DBGJN-së, Sekretari i Përgjithshëm lidh kontrata me përkthyes në atë gjuhë, pasi të jenë ndjekur të gjitha procedurat që aplikohen për miratimin e listës vjetore të përkthyesve të jashtëm të Ministrisë së Drejtësisë. Përkthyesit e kontraktuar me këtë procedurë duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 9 të këtij udhëzimi dhe numri i tyre nuk duhet të kalojë 1/3 e numrit të përkthyesve të jashtëm të miratuar në listën vjetore.

9. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për përkthyes të jashtëm janë:

I. Kriteria të përgjithshme:

- a) Të jetë shtetas shqiptar.
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- c) Të ketë mbaruar arsimin e lartë për gjuhën përkatëse ose për drejtësi në një nga universitetet, gjuha e të cilit është ajo për të cilën aplikon.
- d) Të ketë eksperiencë pune prej jo më pak se tre vjetësh në përkthim ose në nivelin e mësimdhënies.
- e) Të mos ketë qenë dënuar apo të mos jetë në ndjekje penale.
- f) Të zotërojë shumë mirë programet bazë të kompjuterit.

II. Kriteria të veçanta:

- a) Të njohë shumë mirë gjuhën në të cilën kërkon të përkthejë.
- b) Kanë përparësi:
 - i) personat që kanë ndjekur studime të thelluara të fushës në fjalë;
 - ii) personat që e kanë gjuhë amtare gjuhën të cilën kërkojnë të përkthejnë;
 - iii) të diplomuarit apo të specializuarit jashtë vendit;
 - iv) personat që kanë dhënë provimin përkatës të gjuhës të cilën kërkojnë të përkthejnë brenda apo jashtë vendit me rezultate të larta.

10. Përkthimi i dokumenteve zyrtare shpërblehet për faqe kompjuterike. Faqja kompjuterike përmban 2200 (dy mijë e dyqind) shkronja e shenja, duke përfshirë dhe ndarjet e nevojshme të materialit të shkruar në fjalë, kryeradhë, paragrafë, kapituj dhe pjesë. Skicat, fotot, tabelat e skemat që përfshihen në tekstin e përkthyer, llogariten e shpërblehen mekanikisht si faqe kompjuterike sipas vendit që zënë në tekst.

11. Tarifa e shpërblimit për përkthyesit e jashtëm, për përkthim të dokumenteve zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën e huaj të jetë 1300 (një mijë e treqind) lekë për faqe.

12. Tarifa e shpërblimit për përkthyesit e jashtëm, për përkthim të dokumenteve zyrtare nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe të jetë 1000 (një mijë) lekë, për faqe.

13. Përkthimi në konferenca apo takime të ndryshme në të cilat Ministri i Drejtësisë apo persona të autorizuar prej tij marrin pjesë, llogariten mbi bazën e kohës fizike të shpenzuar. Një orë përkthim shpërblehet me 3500 (tre mijë e pesëqind) lekë.

14. Pagesa për përkthimin bëhet në përputhje me kontratën tip që lidhet midis palëve, në CASH ose me transfertë bankare, jo më vonë se 30 ditë, nga dita e marrjes në dorëzim të materialit të përkthyer nga Drejtoria e Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar dhe daljes së urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për këtë qëllim.

15. Mënryra, kushtet dhe afatet e realizimit të përkthimit të dokumenteve zyrtare rregullohen shprehimisht në kontratën tip që lidhet midis palëve, për përkthimin e dokumenteve zyrtare.

16. Në rastin kur të tretët kërkojnë një përkthim zyrtar prej Ministrisë së Drejtësisë, tarifa e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët, për përkthimin nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj të jetë 1800 (një mijë e tetëqind) lekë për faqe. Për përkthimin nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe tarifa e shpërblimit të jetë 1300 (një mijë e treqind) lekë, për faqe.

17. Mënryra, kushtet dhe afatet e realizimit të përkthimit zyrtar për të tretët rregullohen në kontratën tip që lidhet midis palëve.

18. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi, përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Drejtësisë.

19. Ngarkohet Drejtoria e Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Fatmir Xhafaj

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

VENDIM
Nr.11, datë 27.5.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 13.2.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.11 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1.KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Idar Bistri, me autorizim.

2.KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga Ilir Panda, Sokol Çomo e Gjovalin Përnoca, me autorizim.

3. MINISTRIA E DREJTËSISË, përfaqësuar nga Fatmir Xhafaj e Ardian Dvorani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 6, pika 9 dhe nenit 11, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, si dhe nenit 31, pikat 1 e 3 dhe nenit 16, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”

Kërkuesi ka parashtruar se:

- Dhënia e së drejtës së inspektimit e kontrollit mbi veprimtarinë e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe e procedimit disiplinor të gjyqtarëve të këtyre gjykatave Ministrisë së Drejtësisë, bie ndesh me pavarësinë e pushtetit gjyqësor;

- Kjo shmangie e ndërhyrje e pushteteve të tjera në veprimtarinë e pushtetit gjyqësor prek dhe nenin 7 të Kushtetutës ku sanksionohet parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve;

- Veç tyre, dispozitat e lartpërmendura prekin përmbajtjen e neneve 137 dhe 147 të Kushtetutës ku parashikohet se Këshilli i Lartë i Drejtësisë është i vetmi organ që vendos lidhur me procedimin disiplinor dhe lejimin e procedimit penal të gjyqtarëve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Lartë, me vendimin nr.3, datë 10.11.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ka pezulluar gjykimin e çështjes me kërkues Besnik Qira me objekt, ankimin kundër vendimit nr.139/1, datë 6.5.2003 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 6, pika 9 dhe nenit 11, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.8678 datë 4.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, si edhe nenit 31, pikat 1 e 3 dhe nenit 16, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme që, para së gjithash, të citohet përmbajtja e dispozitave ligjore, të cilat kërkohen të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën.

Në bazë të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” neni 6, pika 9: “Ministri i Drejtësisë, kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit”; ndërsa sipas nenit 11 pika 3, shkronja “b”: “Drejtorja e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë kryen inspektime në gjykata dhe gjyqtarë të veçantë, sipas ligjit dhe përgatit rekomandime për Ministrin e Drejtësisë lidhur me marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe për shkeljet e konstatuara”.

Ligji nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” (më poshtë KLD), në nenin 31, pika 1 ka përcaktuar: “Ministri i Drejtësisë kryen inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit për organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, si dhe realizon e vendos për procedimin disiplinor të gjyqtarëve të tyre”; ndërsa pika 3 e këtij neni, përcakton: “Ministri i Drejtësisë në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të tij, propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve pranë KLD-së”. Veç këtyre, neni 16, pika 1, shkronja “c”, e cila bën fjalë për detyrat e KLD-së, parashikon: “Në rastin kur vërehen shkaqe ligjore për procedim disiplinor, relacioni shpjegues dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet zëvendëskryetarit të KLD-së, i dërgohen menjëherë Ministrit të Drejtësisë për të gjykuar për procedimin disiplinor”.

Bazuar në paragrafin e parë të nenit 48, të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe të shkaqeve të parashtruara në të, Gjykata Kushtetuese, merr përsipër të shqyrtojë e të shprehet për pajtueshmërinë me Kushtetutën, por, vetëm për ato dispozita që përfshihen në objektin e kërkesës përderisa nuk ekzistojnë shkaqe të përligjura për të zbatuar nenin 48, pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për t’ia nënshtruar kontrollit kushtetues dhe dispozita të tjera të pakërkuara nga Gjykata e Lartë.

Kushtetuta përcakton se pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm nga gjykatat; nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë. Krahës kësaj, standardet e tjera kushtetuese lidhur me pavarësinë e pushtetit, kanë të bëjnë me garancitë që gjyqtarët gëzojnë lidhur me emërimin, paprekshmërinë e palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura që kanë të bëjnë me mosndjekjen e tyre penalisht dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të KLD-së. Ndër këto standarde, Kushtetuta, në nenin 147, pika 4, ka përcaktuar se KLD-ja, vendos për transferimin e gjyqtarëve si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit. Nga përmbajtja e fryma e kësaj dispozite del se Kushtetuta nuk i ka parashikuar shprehimisht si standarde të tilla problemet që kanë të bëjnë me inspektimet apo me fillimin e procedimit disiplinor.

Sa sipër, me rëndësi është fakti se KLD-ja, është organi i vetëm që vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Këto aspekte kushtetuese ligjvënësi i ka zbërthyer në dy ligjet, dispozitat e të cilave janë objekt gjykimi, si dhe në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenin 11 ka përcaktuar se “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, qoftë KLD-ja apo Ministri i Drejtësisë nuk kanë të drejtë të kontrollojnë e të vlerësojnë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar edhe praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë.

KLD-ja mund të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve pa e kushtëzuar atë me faktin nëse ky vendim ka marrë formë të prerë,¹ vetëm për raste kur vendimet shoqërohen me akte dhe sjellje që

¹ Vendim nr.29, datë 30.4.2001 i Gjykatës Kushtetuese

diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor,

Ky qëndrim është pranuar edhe në Rezolutën nr.(94)12, sipas së cilës: "... vendimet e një gjyqtari nuk mund të bëhen objekt rishikimi jashtë sistemit të apelimit siç parashikon ligji".²

Duke ballafaquar dispozitat e kontestuara me konceptet e kushtetutës, Gjykata Kushtetuese konstaton se në këto dispozita nuk bëhet fjalë për kontroll mbi vendimmarrjen (mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes, administrimit e vlerësimit të provave), por për inspektime në lidhje me administrimin e drejtësisë e me shërbimet gjyqësore.

Parashtrimi në vendimin e kolegjive të bashkuara, se e drejta e Ministrit të Drejtësisë për të kryer inspektime të gjykatave dhe të gjyqtarëve si dhe e drejta e tij për të propozuar pranë KLD-së marrjen e masave disiplinore, përfshi dhe shkarkimin e gjyqtarëve, përbëjnë kompetenca që cenojnë parimin e ndarjes së pushteteve dhe parimin e pavarësisë së gjyqtarëve, përkatësisht të sanksionuara në nenet 7 dhe 145 të Kushtetutës, nuk është i saktë.

Sipas nenit 7 të Kushtetutës: "Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor". Ky parim mund të kuptohet saktësisht në qoftë se formulimi kushtetues studiohet në plotësinë dhe tërësinë e tij, nga ku evidentohet qartë, jo vetëm ndarja e tre pushteteve, por dhe balancimi i tyre. Nëse Kushtetuta do të kishte pasur parasysh sanksionimin vetëm të ndarjes së tre pushteteve, nuk do të ishte e nevojshme, madje do dukej fare pa kuptim togfjalëshi "dhe balancimin ndërmjet pushteteve". Megjithatë këto pushtete janë të ndara në aspektin e autonomisë funksionale dhe në pavarësinë e ushtrimit të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta, ato balancojnë njëri-tjetrin nëpërmjet bashkëveprimit ndërmjet tyre për ushtrimin e detyrave, duke respektuar, nxitur, mbështetur dhe kontrolluar njëri-tjetrin.

Parimi i ndarjes së pushteteve nuk do kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontroleve dhe ekuilibreve. Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron që të parandalohet çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibret që njeh Kushtetuta, i japin secilës degë, pushtete që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizë të fundit, asnjë pushtet në vete nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjera dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok, që natyrisht nuk ndërhyr në atë masë sa të dëmtojnë misionet e tyre kushtetuese.

Në nenin 145 të Kushtetutës sanksionohet, se gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Me këtë kuptohet pavarësia, përgjegjësia dhe kompetenca e veçantë e gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet zgjidhjes së çështjeve konkrete. Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë. Këto koncepte, mbi pavarësinë e gjyqësorit dhe e gjyqtarëve gjejnë pasqyrim dhe në deklaratën e Këshillit konsultativ të gjyqtarëve europianë, sipas së cilës "... principet themelore të statusit të gjyqtarit të jenë të përcaktuara në normat e brendshme të nivelit më të lartë dhe në rregulla të nivelit legjislativ".³

Gjyqtarët kanë detyrim të japin vendime në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, prandaj janë vendosur mekanizma apo rregulla që sigurojnë shmangien nga presionet, që mund të vijnë edhe nga funksionarë apo struktura të tjera, apo edhe nga brenda gjyqësorit nëpërmjet gjyqtarëve të niveleve më të larta ose që bëjnë pjesë në organizma vendimmarrëse për karrierën dhe statusin e gjyqtarit.

Në kuptim të nenit 147, pika 4 të Kushtetutës dhe ligjeve të lartpërmendura, KLD-ja është i vetmi organ që ka kompetencë të marrë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve të

² Deklarata e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve European

³ Deklarata e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve European

shkallës së parë dhe të apelit, pavarësisht se kush ka bërë verifikimin e shkeljes dhe kush bën propozimin për masën disiplinore.

Këtë kompetencë KLD-ja e zbaton duke vepruar si organ që dëgjon “palët” dhe administron provat e nevojshme rreth pretendimeve të parashtruara.

KLD-ja është e lirë që të mos pranojë asnjë kërkesë apo propozim që vjen për masa disiplinore, kur nuk krijon bindjen se shkelja ekziston dhe nëse është i tillë që justifikon masën. KLD-ja vepron si një organizëm demokratik, sepse gjyqtari jo vetëm që njihet paraprakisht me gjithë materialet në ngarkim të tij, por merr pjesë në mbledhje të KLD-së, mund të përfaqësohet edhe nga avokati, ka të drejtë të bëjë çdo sqarim apo të kundërshtojë çdo akuzë, duke paraqitur edhe prova që i çmon të nevojshme.

Nga njëra anë përbërja e KLD-së, ku 2/3 janë përfaqësues të gjyqësorit, dhe nga ana tjetër, funksionimi i tij mbi baza demokratike, e bëjnë këtë organ që të jetë objektiv dhe të marrë masa të drejta kur vërtetohen shkelje, si dhe të vihet në mbrojtje të gjyqtarëve ndaj akuzave të padrejta. Kështu që, për këtë organ pak rëndësi ka se kush bën propozimin. Jo vetëm kaq. Sipas nenit 16 shkronjës “ç” të ligjit për KLD-në, ky organ ka të drejtë dhe detyrë që të kryejë verifikime për procedimin disiplinor të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, në rastet kur çmohet dhe kërkohet nga KLD-ja. Në këto kushte KLD-ja ka dhe instrumentet e duhura, Inspektoratin e tij, që të verifikojë çdo propozim që i vjen për procedimin disiplinor. Duke qenë kështu, fakti që sipas ligjit, Ministri ka të drejtë të kryejë inspektime dhe në përfundim, kur vërteton shkelje që passjellin përgjegjësi disiplinore, të nisë procedimin disiplinor, nuk përbën ndonjë zgjidhje me karakter antikushtetues, sepse nuk vjen në kundërshtim me nenet 7 e 145 të Kushtetutës.

Zgjidhje analoge ndeshen edhe në vende të tjera si në Itali, Gjermani, Greqi etj., dhe kjo përbën një argument për të konkluduar se zgjidhja e bërë në legjislacionin shqiptar nuk prek parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe të pavarësisë së gjykatave e të gjyqtarëve.

Ministri i Drejtësisë është anëtar i KLD-së, por që thjesht parashtrohet çështjen dhe nuk ka të drejtë vote. Inspektorati i KLD-së drejtohet nga zëvendëskryetari i KLD-së, i cili ndjek veprimet e Inspektoriatit për verifikimin e ankesave, organizon veprimtarinë e përditshme të KLD-së. Kryeinspektori dhe inspektorët emërohen dhe shkarkohen nga KLD-ja me propozim të zëvendëskryetarit dhe së fundi, ai në mungesë të kryetarit, zëvendëson atë duke drejtuar dhe mbledhjet e KLD-së. Duke parë këto rregullime ligjore, duket fare qartë se ndikimi i Ministrit të Drejtësisë mbi KLD-në është i pallogaritshëm, nëse verifikimi dhe propozimi i masës disiplinore do të bëhej nga KLD-ja nëpërmjet Inspektoratit të tij.

Veç kësaj, fakti se Ministri i Drejtësisë ka të drejtën për të filluar procedimin disiplinor, por që nuk ka të drejtën e votës në KLD, kurse të drejtën e vendimmarrjes e ka ky i fundit, e ndan funksionin “e akuzës” apo të propozuesit nga ai gjykimi, dhe krijon mundësi më të mëdha që KLD-ja të ruajë paanshmërinë në vendimmarrje, parim ky i rëndësishëm për një proces të rregullt ligjor. Nisur edhe nga këto kritere, në nenin 16, shkronja “c” të ligjit “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë”, është parashikuar se Inspektorati: “Në rastin kur vërehen shkaqe ligjore për procedimin disiplinor, relacioni shpjegues dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet zëvendëskryetarit të KLD-së, i dërgohen menjëherë Ministrit të Drejtësisë për të gjykuar për procedimin disiplinor”.

Për zgjidhjen e rastit konkret, Gjykata Kushtetuese niset jo nga mënyra se si kuptohen dhe zbatohen nga organet përkatëse, respektivisht Ministria e Drejtësisë dhe KLD-ja dispozitat që janë çmuar se vijnë ndesh me Kushtetutën, por nga fakti se sa këto dispozita janë në pajtim me Kushtetutën dhe me standardet kushtetuese e aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Ky dallim është i domosdoshëm të bëhet sepse lidhet pazgjidhshmërisht me atë që përbën funksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe pikërisht kontrollin e pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe jo mbi mënyrën e zbatimit të tyre apo të harmonizimit midis tyre. Mënyra e të kuptuarit dhe e të zbatuarit të ligjit e të harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera, nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe për rrjedhojë nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

Veç sa më lart, kjo Gjykatë çmon se për të dy ligjet, si dhe për ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ekziston nevoja për një përmirësim të tyre. Ekzistenca e dy inspektorateve që duket se dublojnë njëri-tjetrin, përkufizimi dhe përcaktimi i qartë i

nocioneve inspektim, kontroll, verifikim, evitimi i ndërthurjes së kompetencave midis dy inspektorateve dhe dy institucioneve (Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së) lidhur me administrimin e drejtësisë e të shërbimeve, si dhe të vendosjes së kufijve të qartë mbi kontrollin në gjykatat dhe gjyqtarët, janë disa nga çështjet që në kuadrin e përgjithshëm të përmirësimit të legjislacionit kanë nevojë për studim dhe rishikim nga organet përkatëse.

Nga sa u parashtrua, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131, 134 e 145 të Kushtetutës, si dhe në nenet 26/1, 68 e 69 të ligjit nr.8577 datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam dakord me mendimin e shumicës.

Ligji nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe ligji nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, përmbajnë elementë antikushtetues përsa i përket kompetencave të Ministrit të Drejtësisë për inspektimin e veprimtarisë së gjyqtarëve.

Para se të hyjmë në analizën konkrete të përmbajtjes së dispozitave ligjore në kontestim, ia vlen të vëmë në dukje se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë që ka hyrë në fuqi në 28.11.1998, bën pjesë në Kushtetutat e avancuara e bashkëkohore, në të cilat janë sanksionuar qartë jo vetëm parimet e sovranitetit të popullit (neni 2) e të shtetit të së drejtës (hyrja e Kushtetutës e neni 4 i saj), por edhe ai i ndarjes e balancimit të pushteteve ligjvënës, ekzekutiv e gjyqësor.

Parimi i shtetit të së drejtës në lidhje me atë të ndarjes së pushteteve nënkupton garantimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut nëpërmjet një gjyqësori të pavarur e të paanshëm. Në këtë kontekst, ky gjyqësor, duhet kuptuar e pranuar si një gjyqësor që vetëqeveriset, vetëkontrollohet e vetëkorrigjohet.

Vetëqeverisja e gjyqësorit realizohet nëpërmjet një organi të posaçëm “me fytyrën e gjyqësorit” si Këshilli i Lartë i Drejtësisë që vendos për emërimin e masat disiplinore ndaj gjyqtarëve si dhe nëpërmjet buxhetit të pavarur që ka vetë gjyqësori. Vetëkontrolli e vetëkorrigjimi ushtrohet nga instancat më të larta gjyqësore mbi vendimet e instancave më të ulëta, si dhe nëpërmjet masave që merr Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Por, ligji nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe ligji nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, nuk i respekton këto standarde kushtetuese duke zgjeruar kompetencat e Ministrit të Drejtësisë mbi gjyqësorin.

Në zbatim të parimit të ndarjes së pushteteve, Kushtetuta ka bërë ndarje më konkrete të funksioneve e kompetencave midis organeve kryesore të pushteteve të ndryshme dhe madje edhe brenda një pushteti, duke pranuar njëkohësisht edhe ndërhyrjen tek njëri-tjetri. Por, mendoj se kjo ndërhyrje është e pranueshme kur Kushtetuta e shpreh një gjë të tillë ose kur del qartë nga vetë natyra e funksioni i organit kushtetues.

Në raport me organet e tjera, Kushtetuta në nenin 95/2 i ka dhënë kompetencë Këshillit të Ministrave të ushtrojë çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të

tjera, ndërsa në raport me Kuvendin, i ka dhënë kompetencë të nxjerrë akte me fuqinë e ligjit në rast nevojë e urgjence (neni 101). Kuvendi i përcakton me ligj Këshillit të Ministrave aktet nënligjore që duhet të nxjerrë, çështjet që duhen rregulluar dhe parimet në bazë të të cilave do të nxirren këto akte (neni 118/2).

Në raport me gjyqësorin, ekzekutivi mund të interferojë në veprimtarinë gjyqësore deri aty sa ka përgjegjësinë politike qeveria para Kuvendit dhe para popullit, pra deri tek veprimtaria administrative e gjyqësorit.

Për të përcaktuar më konkretisht kufirin ndarës midis kompetencave të këtyre dy pushteteve, pra ekzekutivit e gjyqësorit, duhet t'u referohemi normave kushtetuese e sidomos neneve 100/1, 102/4, 135 e 147 të Kushtetutës.

Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat në bazë të parimit të kontrollit të shkallëzuar të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, ndërsa neni 147 i saj i ka ngarkuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përgjegjësinë kushtetuese për disiplinimin e gjyqtarëve duke i dhënë kompetencë të marrë masa disiplinore deri në shkarkimin e tyre nga detyra. Me ligjin nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" dhe me ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", ky i fundit spostohet nga funksioni procedues e kontrollues duke i dhënë si kompetencë vetëm vendimmarrjen, ndërsa procedimi disiplinor, kontrolli i gjyqtarëve, si dhe relatimi në Këshillin e Lartë të Drejtësisë për shkeljet e bëra nga gjyqtari, i jepen si kompetencë Ministrit të Drejtësisë.

Në të vërtetë, ligji nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", që hyri në fuqi më 30 janar 1999, pra, pak kohë pas Kushtetutës, i ka dhënë Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë rolin kryesor për inspektimin e gjykatave e për verifikimin e ankesave. Duke ecur në rrugën e përmirësimit strukturor e të fuqizimit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe të ndërtimit të një raporti më të drejtë midis ekzekutivit e gjyqësorit zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë u emërua funksionar dhe nuk u mor nga radhët e gjyqtarëve. Qëndrimi për dhënien e rolit kryesor në kontrollin e veprimtarisë së gjykatave e gjyqtarëve Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përbën interpretim e zbatim më të plotë të frymës e përmbajtjes së Kushtetutës.

Përqendrimi i tri kompetencave: të inspektimit të veprimtarisë së gjyqtarit, të nisjes së procedimit disiplinor dhe të relatimit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, vetëm tek Ministri i Drejtësisë sjell indirekt ndikimin e tepruar të ekzekutivit mbi vendimmarrjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe prish balancën midis dy pushteteve. Ligjet e kundërshtuara për antikushtetutshmëri përcaktojnë detyra për Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, i cili jo vetëm vepron paralel me Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por merr rolin kryesor në kontrollin ndaj gjykatave e gjyqtarëve. Kjo bëhet në një kohë, kur Kushtetuta, përgjegjësinë për disiplinimin e gjyqtarëve ia ka dhënë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë është anëtar i saj, pra me të drejtën të veprojë brenda Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ministri i Drejtësisë, duke qenë organi i vetëm që ka kompetencë për të filluar një procedim disiplinor ndaj gjyqtarëve mund të mos e fillojë atë edhe pse mund të kërkojnë anëtarët e tjerë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë mënyrë ministri përcakton e seleksionon gjyqtarët ndaj të cilëve duhet të bëhet procedimi disiplinor, interpreton rrethanat e të dhënat që paraqet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë etj., ndonëse ai mund të ndikohet në politikën e procedimit ndaj gjyqtarëve nga programi apo platforma politike e partisë që përfaqëson.

Parimi i pavarësisë së gjykatave dhe i vetëqeverisjes gjyqësore nuk do të thotë se nuk lejon kontrollin administrativ të ekzekutivit mbi gjyqësorin. Por, ky kontroll nuk mund të cenojë pavarësinë në ushtrimin e kompetencave, në interpretimin e ligjit e provave nga ana e gjyqtarit, bindjen juridike të tij në dhënien e vendimit. Ky kontroll nuk mund të ndikojë gjithashtu në vendimmarrje, ndikim i cili mund të jetë direkt e indirekt mbi gjyqtarin.

Prandaj, mendoj se vetë ligji duhet të ndajë kontrollin e veprimtarisë së gjykatave nga kontrolli i veprimtarisë së gjyqtarit duke i lejuar ministrit kontrollin në çështjet që lidhen me funksionimin e mirëfilltë të gjykatave pra, në veprimtarinë ekzekutive të gjykatave (evidentimi i kërkesave, respektimi i afateve, disiplina etj.).

Dispozitat e kontestuara nga Gjykata e Lartë janë të tilla që nuk vënë kufij të qartë të kontrollit të Ministrit të Drejtësisë me formulime të tilla, si “Ministri i Drejtësisë ... realizon e vendos për procedimin disiplinor të gjyqtarëve” apo duke “... kryer inspektime sipas programeve të posaçme ...”, kur dihet se procedimi disiplinor e programet e posaçme mund të kërkojnë edhe kontrollin në dosje e në vendimet gjyqësore.

Është e vërtetë se për të arritur në një përfundim për antikushtetutshmërinë e dispozitave ligjore nuk mund të nisemi thjesht nga mënyra si zbatohen ato, por kur vetë dispozitat janë të paqarta e pa kufij të përcaktuar, si në rastin në shqyrtim, ato lënë vend për antikushtetutshmëri e si të tilla duhen shfuqizuar.

ANËTAR
K. Puto

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam dakord me qëndrimin e mbajtur nga shumica në këtë vendim. Çështja e paraqitur për shqyrtim nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në rrugën e kontrollit incidental, është ndër ato raste, të cilat, për arsye të kompleksitetit të problematikës që paraqet, nuk kërkon përfundime oportuniteti në drejtim të përmirësimit legjislativ, por zgjidhje përfundimtare të aspektit të drejtësisë kushtetuese.

Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si trupë vendimmarrëse që shqyrton ankesat e gjyqtarëve të shkarkuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i ka rezultuar nga rasti në shqyrtim se ligji “Për Ministrinë e Drejtësisë” dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në disa dispozita ligjore kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe bien ndesh me konceptet kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së gjyqësorit.

Problemi është fokusuar nga kërkuesi në dy aspekte kryesore: në çështjen e të drejtës së Ministrit të Drejtësisë për të kryer inspektim në gjyqtarë të veçantë, si dhe në të drejtën e tij për të filluar procedimin disiplinor ndaj tyre. Këto dy çështje nuk janë të njëjta në trajtim nga pikëpamja kushtetuese. Koncepti im për zgjidhjen që i është dhënë kësaj çështjeje nga Gjykata Kushtetuese nuk pajtohet, kryesisht, me qëndrimin e mbajtur ndaj të drejtës së Ministrit të Drejtësisë për të kryer inspektime në gjyqtarë të veçantë.

Për të argumentuar qëndrimin tim në pakicë, është e domosdoshme që rasti në shqyrtim të trajtohet më në gjerësi. Ky konflikt, nëse do ta konsiderojë të tillë marrëdhënien që krijohet ndërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, paraqitet më shumë si çështje mosmarrëveshesh ndërmjet organeve kushtetuese. Megjithatë, derisa kjo çështje u inicua në Gjykatën Kushtetuese në aspektin e kushtetutshmërisë së normës nëpërmjet një gjykimi incidental, sigurisht, që do ta gjente zgjidhjen vetëm në kuptim të nenit 145 të Kushtetutës dhe jo të mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet pushteteve.

Çështja kryesore që unë shtroj është raporti kushtetues që duhet të ekzistojë ndërmjet gjyqtarit dhe organeve kushtetuese. Neni 147 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, i parë në harmoni me parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, duket se i jep zgjidhje kësaj çështjeje. Sipas këtij formulimi, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore. Ministri i Drejtësisë, të vetmen lidhje që ka në aspektin e procedimit disiplinor të gjyqtarëve është qenia e tij anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kushtetuta nuk i ka dhënë Ministrit të Drejtësisë ndonjë pushtet më të lartë se të anëtarëve të tjerë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pozicioni i tij sipas Kushtetutës, në raport me të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të konsiderohet si *paris inter paris*. Sipas këtij kuptimi që i ka dhënë Kushtetuta pozicionit të këtyre organeve në raport me gjyqtarin, rezulton se përgjegjësinë kushtetuese për disiplinimin e tyre e ka vetëm Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” ka rregulluar pikërisht këto raporte që krijohen ndërmjet organeve kushtetuese. Sipas këtij ligji, procedimi disiplinor për gjyqtarët vihet në lëvizje nga Ministri i Drejtësisë mbi bazën e inspektimit të kryer nga Inspektorati i ngritur pranë Këshillit të

Lartë të Drejtësisë. Detyrë kryesore e këtij inspektorati, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr.8546, datë 5.11.1999, është inspektimi i gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, verifikimi i ankesave për gjyqtarët, evidentimi i aftësive të tyre profesionale dhe kontrolli i organizimit të punës së shërbimeve gjyqësore etj. Ndërkohë, me ligjin nr.8678, datë 14.5.2001 “Për Ministrinë e Drejtësisë” dhe me ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, pa u ndryshuar apo shfuqizuar kompetencat e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, u parashikua ngritja e një strukture paralele inspektimi dhe kontrolli mbi gjykata dhe gjyqtarë të veçantë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Pikërisht kjo përplasje ndërmjet ligjeve, që sipas shumicës nuk përbën çështje kushtetutshmërie, për mendimin tim, shkakton konfondime juridiksionesh ndërmjet organeve kushtetuese dhe, për rrjedhojë sjell ndikime negative mbi kuptimin e pavarësisë dhe të mbikëqyrjes së gjyqësorit. Jo vetëm kaq, por doktrina kushtetuese ka avancuar në drejtim të krijimit të koncepteve të qarta mbi pakushtetutshmërinë që mund të shfaqë kolizioni ligjor. Për të argumentuar këtë qëndrim thirret në ndihmë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr.32, të vitit 2003, orientohet në këtë drejtim. Prandaj shmangia e situatës së paqartë ligjore që vjen nga mënyra e zbatimit të ligjeve që kundërshtojnë njëri-tjetrin në elemente esenciale të tyre, përbën një argument të rëndësishëm për të shfuqizuar dispozita të veçanta të këtyre ligjeve si të papajtueshme me Kushtetutën.

Një situatë e tillë ekziston në disa dispozita të ligjeve objekt shqyrtimi. Për këtë mjafton t'i referohemi nenit 11, pika 3, shkronja “b” të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, nenit 16 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe nenit 17 të ndryshuar të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”. Sipas këtyre dispozitave, inspektimi mbi gjyqtarë mund të kryhet njëkohësisht si nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ashtu edhe nga inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë.

Pakushtetutshmëria në dispozitat e sipërcituara nuk qëndron vetëm në përplasjet juridiksionale që ato krijojnë, por edhe në aksesin që ligji u krijon inspektorëve për t'u përfshirë në kontrollin e vendimmarrjes gjyqësore. Për këtë mjafton të citoj dy dispozita, për mendimin tim, të atakueshme nga pikëpamja kushtetuese. Në nenin 11 pika 3 shkronja “b” të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” parashikohet: “Drejtoria e Inspektimit...kryen inspektime në gjykata dhe gjyqtarë të veçantë .” Në nenin 31 pika 3 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” thuhet : “Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para Këshillit të Lartë të Drejtësisë...”. Dy janë momentet e rëndësishme dhe të diskutueshme nga pikëpamja kushtetuese që rezultojnë nga shqyrtimi i dispozitave të sipërcituara:

E para, e drejta e fillimit të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve është përqendruar vetëm në diskrecionin e përfaqësuesit të ekzekutivit;

E dyta, ligji i lejon dhe i krijon hapësirë inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë që të vlerësojnë vendimmarrjen e gjyqtarëve. Problemi qëndron më shumë në çështjen e dytë.

Sipas Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë katër janë rastet se kur gjyqtari mund të shkarkohet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këto katër raste duhet të konsiderohen si raste përjashtimore, të cilat aplikohen rrallë dhe që kanë të bëjnë me veprime apo mosveprime, të cilat nuk mund të lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me vendimmarrjen dhe nuk janë rezultat i përfundimit të inspektimit nga Drejtoria e Inspektimit pranë Ministrisë së Drejtësisë. Kjo drejtori, detyrë kryesore në kuptim edhe të funksionit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë, ka inspektimin e gjykatave lidhur me organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore dhe administrimin gjyqësor në përgjithësi, të parashikuara këto në nenin 11 pika 3 shkronja “a” të ligjit përkatës.

Përfundimi i inspektimit mbi gjyqtarë të veçantë dhe bërja prezente e rezultateve të tij Ministrinë të Drejtësisë për të filluar procedimin disiplinor duket se shmanget nga kuptimi që dispozita e mësipërme kushtetuese parashikon si shkaqe që shërbejnë për shkarkimin e gjyqtarëve. Konkretisht, kryerja e një krimi dhe paafësia mendore a fizike nuk janë raste të cilat mund të vërtetohen drejtpërdrejt nga inspektorët, sepse ato raste kërkojnë paraprakisht të konstatohen dhe të vërtetohen nga organet kompetente. Ndërsa dy rastet e tjera që lidhen me aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarëve dhe pamjaftueshmëria profesionale janë

vlerësime që i bën Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si organi që mban edhe përgjegjësinë kushtetuese për disiplinimin e gjyqtarëve. Përfshirja në ligj edhe e të drejtës së inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë për të ushtruar këtë funksion kontrolli krijon një sistem të dyzuar inspektorësh që së bashku me autoritetin vendimmarrës të Ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, sjell përqendrimin në duart e tij të shumë funksioneve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke zbehur në këtë mënyrë rolin mbikëqyrës në aspektin disiplinor të këtij të fundit mbi gjyqësorin.

Shumica nuk gjen argumente për pranimin e kërkesës, për arsye se koncepti i saj për kontrollin kushtetues në këtë çështje rezulton i ndryshëm nga koncepti jo vetëm imi, por edhe i vetë jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në raste të tjera analoge. Shumica arsyeton se mënyra e të kuptuarit dhe të zbatuarit të ligjit, mosharmonizimi i dispozitave ligjore ndërmjet tyre, dublimi apo ndërthurja e kompetencave ndërmjet inspektorëve, si dhe paqartësia ligjore në drejtim të mosvendosjes së kufijve të qartë mbi kontrollin në gjykata e gjyqtarë, nuk përbëjnë çështje kushtetutshmërie, por të rishikimit legjislativ.

Për mendimin tim, mjafton ekzistenca e këtyre momenteve tepër delikate në ligjet objekt shqyrtimi, të cilat i ka pranuar edhe vetë shumica në vendimin e saj dhe që përbëjnë shkak për antikushtetutshmëri, që kërkesa të pranohej.

Për këto arsye konkludoj se dispozitat ligjore që lidhen me të drejtën e Ministrit të Drejtësisë për të kryer inspektime në gjyqtarë të veçantë dhe konkretisht neni 11 pika 3 shkronja “b” e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe neni 31 pika 3 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” duhej të shfuqizoheshin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

ANËTAR
S. Sadushi

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam i një mendimi me shumicën, e cila ka rrëzuar kërkesën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me objekt shpalljen si antikushtetuese të nenit 6 pika 9 dhe nenit 11 pika 3/b të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, si dhe nenit 16 pika 1/c e nenit 31 pikat 1 e 3 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë, ndërmjet të tjerash, është shprehur se, dispozitat e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenet 7 e 147 të Kushtetutës. Njohja e kompetencës së Ministrit të Drejtësisë për inspektimin e gjykatave dhe gjyqtarëve të veçantë dhe të procedimit disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, vjen në kundërshtim me pavarësinë e pushtetit gjyqësor, i cili është organizuar si një pushtet më vete, që vetëkontrollohet dhe vetëkorrigjohet. Ministri i Drejtësisë nuk mund të dublojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë, duke nisur procedimin disiplinor pa pëlqimin e këtij Këshilli, sepse Kushtetuta nuk ia njeh një të drejtë të tillë.

Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me cilësinë e subjektit të interesuar në gjykim, lidhur me këtë çështje, në mënyrë të përmbledhur, u shpreh se edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sikurse Gjykata e Lartë, i konsideron [dispozitat e kundërshtuara] se vijnë në kundërshtim me nenet 7 e 147 të Kushtetutës; lidhur me pavarësinë gjyqësore, dokumentet ndërkombëtare, përveç të tjerave, parashikojnë se ... gjyqtari duhet të vendosë për çështjet para tij, në mënyrë të paanshme, mbi bazën e fakteve dhe në përputhje me ligjin, pa asnjë kufizim, influenza, ... direkte ose indirekte ..., [se] në procesin gjyqësor nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të papërshtatshme e të pajustificueshme, [dhe se] pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv duhet të sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve dhe mosmarrjen e hapave që mund të rrezikojnë pavarësinë e gjyqtarëve; Ministri i Drejtësisë është pjesë e ekzekutivit dhe si i tillë ai është përfaqësues i një programi politik të një mazhorance të caktuar; [pra], Ministri i Drejtësisë është një organ që ndryshon në mënyrë dinamike dhe për pasojë, politika e tij proceduese ndaj gjyqtarëve do të ndryshonte sa herë do të ndryshonte mazhoranca politike; gjyqtarët, megjithëse janë të palëvizshëm në detyrë dhe me status të

caktuar, rrezikohen që të trajtohen ndryshe dhe në mënyrë subjektive nga ministra/persona të ndryshëm; duke i dhënë të drejtë Ministrit të Drejtësisë të inspektojë gjyqtarët, njëri nga elementet e procesit disiplinor që është verifikimi fillestar, nuk i besohet një strukturë të pavarur nga ekzekutivi, siç kërkohet nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare.

Me cilësinë e subjektit të interesuar në gjykim, Ministri i Drejtësisë, lidhur me çështjen në shqyrtim, në esencë është shprehur se ndërhyrja e ekzekutivit nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, me mjetet që i jep ligji është e bazuar ... në parimin kushtetues të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve; e drejta e Ministrit të Drejtësisë për të inicuar procedimin disiplinor apo edhe për të realizuar kontrollin në gjykata nuk cenon thelbin e parimit kushtetues të ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve; nga ... dokumentet ndërkombëtare ... vërehet se asnjë nga këto dokumente as nuk mohon dhe as kërkon që kontrollet dhe inspektimet të mos kryhen nga Ministri i Drejtësisë ... [por] ... kërkohet që, vënia në lëvizje e Ministrit të Drejtësisë të bëhet duke respektuar parimin e mosndikimit të pajustificuar dhe abuziv në veprimtarinë e gjyqtarëve dhe mbi të gjitha, duke respektuar parimin e mosndërhyrjes në interpretimin dhe bindjen juridike të gjyqtarit në dhënien e vendimit, ...

Në rastin në shqyrtim, objekti i kontrollit kushtetues, është nëse dispozitat e kundërshtuara të ligjeve të mësipërme, i kanë dhënë ekzekutivit kompetenca që cenojnë pavarësinë gjyqësore dhe nëse inspektimi mbi gjykatat dhe gjyqtarët e veçantë, ashtu siç është rregulluar në kuadrin ligjor ekzistues, cenon veprimtarinë vendimmarrëse të gjyqtarit.

Në këtë drejtim, është e nevojshme të japim disa konsiderata parimore lidhur me standardin kushtetues të pavarësisë gjyqësore.

Pavarësia gjyqësore, si një nga parimet strukturore të Kushtetutës, është shprehje e parimit të ndarjes së pushteteve, si dhe një nga standardet themelore të veprimtarisë shtetërore. Pavarësia e gjyqtarëve, si një nga kushtet e nevojshme për të vendosur sundimin e të drejtës në shoqëri, duhet të realizohet në tre aspekte: pavarësi nga palët, pavarësi nga shoqëria dhe pavarësi nga shteti. Në rastin në shqyrtim, ne duhet të ndalemi në aspektin e tretë.

Në këndvështrimin e pavarësisë gjyqësore, një rëndësi të veçantë merr parimi i palëvizshmërisë së gjyqtarit, aplikimi i të cilit garanton një ecuri normale të punës pa u influencuar nga kërcënime lidhur me ekzistencën e tij si gjyqtar. Elemente të rëndësishme të palëvizshmërisë janë garancia kushtetuese e moskufizimit të kohës së qëndrimit në detyrë (neni 138), lënia e çështjeve të disiplinimit dhe veçanërisht të shkarkimit, në kompetencë të një organi të pavarur nga pushtetet e tjera siç është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si dhe parashikimi në Kushtetutë i rasteve të shkarkimit të gjyqtarëve (neni 147/4/6). Si elemente të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me garancinë e pavarësisë gjyqësore janë edhe garancia e imunitetit të gjyqtarëve (neni 137), pavarësia buxhetore e gjykatave, etj.

Neni 147 i Kushtetutës ka ngarkuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë për të vendosur ... për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve sipas ligjit. Kushtetuta nuk trajton çështjet e kontrollit të gjykatave, të gjyqtarëve të veçantë apo atë të nisjes së procedimit disiplinor, pra nuk përcakton as organin që duhet t'i kryejë këto funksione e as procedurat përkatëse në këtë drejtim. Këto çështje janë rregulluar në ligjin nr.8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", neni 6/9, i cili i ngarkon Ministrit të Drejtësisë detyrën të kryejë inspektime dhe të bëjë procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit.

Neni 147 i Kushtetutës duhet të interpretohet në këndvështrimin e nenit 7 të Kushtetutës. Në këtë nen të fundit është parashikuar një parim i rëndësishëm strukturor i Kushtetutës, që ka të bëjë me ndarjen dhe balancimin e pushteteve të qeverisjes. Siç pranohet nga doktrina, esenca e këtij parimi konsiston në dhënien secilës prej tre degëve të pushtetit një përgjegjësi parësore qeverisjeje, si dhe pushtete kontrolli dhe ekuilibiri që parandalojnë degët e tjera të ushtrojnë pushtet të pakufizuar. Pranohet gjithashtu se, si pushtetet që janë në natyrën e secilës degë qeverisjeje, ashtu edhe pushtetet balancuese-kontrolluese, rregullohen nga Kushtetuta e jo nga ligjet e zakonshme. Rezervat ligjore nuk mund të dalin jashtë përcaktimeve kushtetuese për këto dy tipe pushtetesh.

Nga një vështrim i dispozitave kushtetuese që përcaktojnë pushtetet konkrete qeverisëse, nuk rezulton që ekzekutivit t'i jetë dhënë ndonjë pushtet kontrollues mbi gjyqësorin në aspektin e disiplinimit. Kjo është një zgjidhje e qëllimshme e hartuesve të Kushtetutës, që ka lidhje direkte me

pavarësinë e gjyqësorit. E vetmja pikë kontakti midis ekzekutivit dhe gjyqësorit është qenia e Ministrit të Drejtësisë si anëtar “*ipso jure*” i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (neni 147/1). Por, vetëm ky fakt nuk mund të shërbejë si bazë që Ministri i Drejtësisë të ngarkohet me funksionin e inspektimit të gjykatave apo gjyqtarëve, si dhe të nisjes së procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve. Ekzekutivit nuk mund t’i jepet me ligj ajo kompetencë që nuk i është dhënë nga Kushtetuta, sikundër Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk mund t’i merret me ligj ajo që i është dhënë nga Kushtetuta, (të vendosë për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve). Funksionin e disiplinimit të gjyqtarëve Kushtetuta ia ka ngarkuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është konceptuar si një nga garancitë kryesore kushtetuese për pavarësinë gjyqësore. Nisja e procedimit disiplinor të gjyqtarëve është një aspekt shumë i rëndësishëm i këtij procesi dhe ka të bëjë direkt me efektivitetin e tij. T’i heqësh këtij organi pushtetin mbi këtë aspekt esencial të procesit, do të thotë të cenosh funksionin e këtij organi e për pasojë, të vësh në rrezik pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Në qoftë se hartuesit e Kushtetutës do të kishin pasur për qëllim që këtë segment të rëndësishëm të procesit disiplinor, pra nisjen e procedimit, t’ia ngarkonin ekzekutivit, atëherë një gjë të tillë do ta rregullonin në mënyrë të shprehur në Kushtetutë.

Çështje si kjo në shqyrtim, pra, nëse ekzekutivi do të ketë kontroll mbi gjyqësorin në aspektin e disiplinimit, kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërinstitucionale (midis tre pushteteve të qeverisjes). Çështje të tilla, për rëndësinë që kanë, përbëjnë objekt të rregullimit kushtetues, dhe teknika të tilla janë përdorur edhe nga kushtetuta të vendeve të tjera.¹ Për pasojë, përderisa Kushtetuta nuk ka parashikuar ndonjë “*check*” ekzekutiv mbi gjyqësorin, ky “*check*” nuk mund t’i jepet ekzekutivit me ligj. Pikërisht për këtë arsye kompetencat e kundërshtuara të Ministrit të Drejtësisë nuk mund të shihen si shprehje e balancimit midis pushteteve.

Kushtetutshmëria e dispozitave ligjore të kundërshtuara duhet të shihet edhe në aspektin e përmbajtjes dhe shtrirjes së inspektimit mbi gjykatat e gjyqtarët e veçantë.

Jurisprudenca kushtetuese ka evidentuar si të palejueshme në aspektin kushtetues kontrollin (inspektimin) mbi veprimtarinë vendimmarrëse të gjyqtarit. Ky kontroll nuk mund të ushtrohet duke ndërhyrë në interpretimin dhe bindjen juridike të gjyqtarit për zgjidhjen e çështjes. Në këtë vështrim, dispozitat e kundërshtuara, që kanë të bëjnë me inspektimin dhe kontrollin mbi gjykatat apo gjyqtarë të veçantë, nga mënyra se si janë formuluar, nuk përjashtojnë mundësinë e ndërhyrjes në veprimtarinë vendimmarrëse të gjyqtarit. Për më tepër, janë identifikuar raste, në të cilat, ndaj gjyqtarëve, janë marrë masa të shkarkimit nga detyra me arsyetimin, se kanë dhënë zgjidhje të gabuara ligjore për çështje që kanë patur në shqyrtim.

Mosndërhyrja në veprimtarinë vendimmarrëse të gjyqtarit është një nga aspektet e rëndësishme të standardit kushtetues të pavarësisë gjyqësore (neni 135/1 i Kushtetutës). Për pasojë, ligjvënësi ka detyrimin kushtetues të pengojë shtrirjen e kontrollit disiplinor në procesin vendimmarrës të gjyqtarit duke rregulluar procedurën e inspektimit. Dispozitat ligjore të kundërshtuara nuk përmbushin këtë standard kushtetues të mosndërhyrjes në aktivitetin vendimmarrës të gjyqtarit duke lejuar kështu një vakum ligjor antikushtetues, që bëhet në këtë mënyrë edhe shkak për shfuqizimin e këtyre dispozitave.

ANËTAR
P. Pllloçi

¹ Kushtetuta Italiane, Neni 107,

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

SË SHPEJTI NË BOTIM:
INDEKSI TEMATIK DHE KRONOLOGJIK
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

Doli nga shtypi më 17.6.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 100 lekë